



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Komiteti Konsultativ për Barazi Gjinore



02 Nr. 052104-63274, dt. 08/12/2022

**Raporti vjetor i punës së Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore për vitin  
2022**

**Janar - Dhjetor, 2022**

**Hyrje:**

- Anëtarët e përzgjedhur të Komitetit Konsultativ për Barazi gjinore në Komunën e Drenasit gjatë periudhës **Janar- Dhjetor 2022**, kanë organizuar dhe mbajtur mbledhjet sa i përket këtij komiteti.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022, **KKBGJ** ka mbajtur disa takime. Ku prej tyre **(6) gjashtë** gjithsej kanë qene mbledhje te rregullta në të cilat përpos diskutimeve në fund te secilit takim ka rezultuar një rekomandim drejtuar institucioneve përkatëse dhe komunës ne Drenas(Gllogoc).

Në secilin takim janë shqyrtuar pika te veçanta dhe rendi i ditës ka qene specifik për secilin takim të mbajtur. Secili takim është shoqëruar me proces verbal dhe raportimin adekuat, pra janë dorëzuar 6 procesverbale të mbledhjeve me lista të pjesëmarrësve.

**Paraqitja e detajuar e shqyrtimit të pikave të rendit të ditës në mbledhjet e mbajtura të Komitetit për Barazi Gjinore gjatë periudhës janar-dhjetor 2022**

Janar, 2022

Mbledhja e parë e rregullt e Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore është mbajtur me datën 24.01.2022, ku janë shqyrtuar (3) tre pika të diskutimit dhe me këtë rend të ditës. Pas mbledhjes është përgatit raporti dhe rekomandimi i KKBGJ-së.

1. Planifikimi vjetor i mbledhjeve të KKBGJ-së për vitin 2022.
2. Vetëdijesimi i të rinjve për pasojat e martesave të hershme, apo nën moshën 18 vjeçare.
3. Të ndryshme.

Rekomandimi i mbledhjes se parë është:

Të organizojmë një fushatë vetëdijesuese me nxënësit e nivelit të mesëm të ulët (klasat e 9-të) dhe nxënësit e shkollës së mesme të lartë (klasa 10-12). Lidhur me pasojat e martesave të hershme nën moshën 18 vjeçare.

Martesa e hershme është shkelje e të drejtave të njeriut dhe privon të dy gjinitë e sidomos vajzat nga arsimimi, shëndeti dhe perspektiva afat-gjatë. Vajza që martohet në fëmijëri do të mbetet pa potencial të plotësuar dhe mendojmë që do të jenë të penguar në zhvillimin e tyre arsimor, profesional, etj.

Ne duhet të punojmë së bashku në pengimin e martesave të hershme.

Duke u bazuar edhe në Ligjin për Familje

#### **Ligji Nr. 2004/32 LIGJI PËR FAMILJEN I KOSOVËS**

Neni 16. Pika 1.

(1) "Personi i cili nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeçare nuk mund të lidhë martesë".

Neni 15. Pika 2.

(2) "Moshë madhore fitohet me të mbushur 18 vjet".

Ky rekomandim i është dërguar: DKA-së dhe Zyrës për Barazi Gjinore.

Mbledhja e dytë e rregullt e Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore është mbajtur më: 31.03.2022, ku janë shqyrtuar (3) tri pika me këtë rend dite dhe nga ky takim po ashtu është nxjerur një rekomandim. Pas mbledhjes është përgatit raporti dhe rekomandimi e KKBGJ.

1. Diskriminimet ne vendin e punës;
2. Vlerësimi profesional e jo ai personal i punëtoreve;
3. Të ndryshme.

Rekomandimi i mbledhjes se dytë është:

**Përgatitja e fletushkave për punëdhënësit kundër diskriminimit të punëmarrësve të institucioneve dhe bizneseve publike dhe private. Me qellim të parandalimit të diskriminimit të punëtoreve.**

Qëllimi i këtij rekomandimi është diskriminimi gjinor ne vendet e punës. Shpesh gjinia bëhet problematike tek disa lloje të profesioneve, ku kërkohet që të ushtrohet vetëm nga gjinia femërorë apo vetëm nga gjinia mashkullore. Ky është një diskriminim serioz, pasi nuk mund të përjashtohemi nga një profesion vetëm për shkak të gjinisë. Kemi edhe diskriminimin pozitiv tek gratë shtatzënë, të cilave ju jepet pushimi i lindjes për një kohë më të gjatë se babait të fëmijës. Kemi diskriminimin tjetër të gjinisë që ka të bëjë me pagesën e pagave, ose përfitimeve, ndodh që një burrë dhe një grua mund të kryejë të njëjtën punë dhe punëdhënësi bën lëshime, duke paguar njëren gjini me page më të lartë se tjetren, për të njëjtën punë që kryejnë.

Punëdhënësi duhet ta paguan punëmarrësin në mënyrë të barabartë, për punë të njëjtë ose punë me vlerë të barabartë, pa diskriminuar.

Si formë parandaluese të diskriminimit kemi edukimin e shoqërisë, që të ndërpriten dallimet ndaj njëri-tjetrit dhe të pranojmë faktin se jemi të gjithë të barabartë si qenie njerëzore. Duhet dinjiteti, guximi dhe mbështetja e viktimave, për të mposhtur diskriminimin.

**Dukë u bazuar në Kushtetutën e Republikës se Kosovës. Neni 24, pika 2.**

**Dhe duke u bazuar ne Ligjin e Punës LIGJI Nr. 03/L-212, Neni 5, pika 1,2,3,4 dhe 5.**

Ky rekomandim i është dërguar: Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, Drejtoria e Inspektionit

Mbledhja e tretë e rregullt e Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore është mbajtur më: 31.05.2022, ku janë shqyrtuar (2) dy pika me këtë rend dite dhe nga ky takim po ashtu është nxjerrur një rekomandim. Pas mbledhjes është përgatitur raporti dhe rekomandimi i KKBGJ.

1. Divorcet martesore
2. Të ndryshme

Rekomandimi i mbledhjes se tretë është:

**Organizimi i fushatave sensibilizuese me çiftet e martuara, kundër rritjes së numrit të divorceve.**

Në 2022, për dy muaj (janar, shkurt) janë 250 raste të shkurorëzimit, raste që kanë vazhduar edhe në muajt në vijim. Ky fenomen po bëhet gjithnjë e më shqetësues, i cila po vjen si pasojë e disa arsyeve, të cilat nëse i analizojmë në thelb nuk janë as "arsye". Duke marr parasysh që shume ndarje çiftesh, po vijnë krejtësisht pa ndonjë arsye, (dhe jo ato ndarje që do të shpëtonin vërtet familjen), tani po vijnë disa ndarje që po e shkatërrojnë familjen dhe kryesisht fëmijët, pra fëmijët janë ata të cilët po e vuajnë më se shumti këtë ndarje, në çdo aspekt: fizik, psikik, emocional, motivues, etj.

Kuptojmë divorcet që duhet të bërë, për shkak të dhunës fizike, psikologjike, por edhe morale, por jo ato për kushte ekonomike, punësore, politike, fetare, etj...

Ne mendojmë që ky fenomen duhet të reduktohet dhe martesat të kuptohet jo vetëm si "zgjidhje e problemeve", por të kuptohet martesat edhe si përgjegjësi.

Shpëtimi i një martese duhet bërë duke biseduar dhe gjetur mënyra të ndryshme për të shpëtuar martesën.

Ne mendojmë se është mirë që të organizohet ndonjë fushatë sensibilizuese me çiftet e martuara, por edhe me ato që janë në një lidhje, që ta kuptojnë martesën si një përgjegjësi e me obligime të cilat janë shumë letë të zbatueshme, e kjo vjen vetëm të këtë bashkëbisedim ndërmjet çifteve.

Ky rekomandim i është dërguar: Zyrës për Barazi Gjinore.

Mbledhja e katërt e rregullt e Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore është mbajtur më: 26.08.2022, ku janë shqyrtuar (2) dy pika me këtë rend dite dhe nga ky takim po ashtu është nxjerur një rekomandim. Pas mbledhjes është përgatitur raporti dhe rekomandimi i KKBGJ.

1. Zbatimi i **LIGJIT Nr.05/L -020 Për Barazi Gjinore**, në rastin e emërimit të institucioneve, shkollave e rrugëve.
2. Të ndryshme

Rekomandimi i mbledhjes se katër është:

**Të kenë parasysh LIGJI Nr. 05/L -020 PËR BARAZI GJINORE, për emërtimin e rrugëve.**

KKBGJ-ja jep rekomandim Komisionit për Emërtimin e Rrugëve të komunës së Drenasit që ta këtë parasysh ligjin Për Barazi Gjinore dhe që për emërtimin e rrugëve të bazohen edhe në këtë ligj, përkatësisht në **Neni 5 pika 1.9, te Ligji Nr. 05/L-020.**

1.9. “të marrë parasysh barazinë gjinore në rastin e emërimit të institucioneve, shkollave e rrugëve”.

Vendi i ynë ka vajza- heroina të shumta të cilat kanë jep kontribut të madh për vendin tone dhe emrat e të cilave e meritojnë të jenë edhe prezentë në rrugët tona.

Ky rekomandim i është dërguar: Komisionit për Emërtimin e Rrugëve

Mbledhja e peste e rregullt e Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore është mbajtur më: 30.09.2022, ku janë shqyrtuar (2) dy pika me këtë rend dite dhe nga ky takim po ashtu është nxjerur një rekomandim. Pas mbledhjes është përgatitur raporti dhe rekomandimi i KKBGJ.

1. Puna mbi normë e punëtorëve në markete dhe butikë të Drenasit
2. Të ndryshme

Rekomandimi i mbledhjes se pestë është:

**Komuna e Drenasit ta angazhoj Inspektoratin e Punës që ta verifikoj zbatimin e legjislacionit nga fusha e marrëdhënies së punës në markete dhe butikë.**

Në këtë takim u diskutua për punën mbi norme të punëtorëve të punësuar në sektorin privat veçanërisht në markete dhe butikë. Kemi të dhëna që punëtorët në markete dhe butikë përveç që punojnë mbi normë ata mezi arrijnë të kenë një ditë pushimi në javë ose çdo dy javë. Po të shikohen kontratat e këtyre punëtorëve gjithçka duket në rregull, por në praktikë ata janë thjesht skllëvër pune pa asnjë të drejtë njerëzore. P.sh. ka markete në komunën e Drenasit që i detyrojnë punëtorët të mbajnë dy ndërrime në një ditë të javës për ta fituar të drejtën e një dite pushimi. Praktikisht këta punëtorë nuk e kanë asnjë ditë të lirë.

Mosrespektimi i kontratave të punës dhe normave javore të punës ka bërë që shumë pak gra të jenë të interesuara për punë. Kjo sepse një nënë ose një bashkëshorte nuk mund të kërkojë të punoj sepse ajo do të detyrohet ta neglizhojë komplet familjen e saj në mungesë të kohës së lirë.

Si përfundim, ne konsiderojmë që **punëtorët në sektorin privat janë të pamotivuar dhe kjo ka bërë që në këtë sektor të ndërrohen punëtorët shpesh**. Gjithashtu, thuhet se ka sjellje jo etikë të menaxherëve apo shefave të këtij sektori.

Në bazë të Ligjit të Punës Ligji Nr. 03/L-212 në Republikën e Kosovës, neni 20, paragrafi 2 përcakton kohëzgjatjen e orarit të punës brenda një jave si më poshtë:

“2. Orari i plotë i punës zgjat dyzet (40) orë në javë, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshme.”

Po ashtu në nenin 31 të këtij ligji thuhet se:” 1. I punësuar ka të drejtë në pushim javor në kohëzgjatje prej së paku njëzetekatër (24) orë pandërprerë.”

Si rrjedhojë ne **rekomandojmë** që Komuna e Drenasit ta angazhoj Inspektoratin e Punës që ta verifikoj zbatimin e legjislacionit nga fusha e marrëdhënies së punës në vendet e lartpërmendura.

Ky rekomandim i është dërguar: Inspektoratit të Punës.

Mbledhja e gjashtë e rregullt e Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore është mbajtur më: 03.11.2022, ku janë shqyrtuar (2) dy pika me këtë rend dite dhe nga ky takim po ashtu është nxjerur një rekomandim. Pas mbledhjes është përgatitur raporti dhe rekomandimi i KKBGJ.

1. 1 Organizimi i trajnimeve profesionale për femra dhe meshkuj me qëllim të përgatitjes së punëtorëve me më pak gjasë punësimi për treg të punës
2. Të ndryshme

Rekomandimi i mbledhjes se gjashtë është:

**Komuna e Drenasit, qoftë si punëdhënës, qoftë si organizues i mundësive për punësim të gjej mënyra për hapjen e mundësive për punësim duke rritur interesimin e grave dhe burrave për punë në sektorë të ndryshme përmes organizimit të trajnimeve/kurseve profesionale.**

Në këtë takim u diskutua për organizimin e trajnimeve apo kurseve profesionale për gratë dhe burrat e komunës së Drenasit të cilët kanë më pak gjasë punësimi si punëtorë të kualifikuar.

Ndjenja e madhe e inferioritetit për të aplikuar për një vend pune, padyshim që është pengesë për të zvogëluar papunësinë në komunën tonë. Ka shumë raste kur shumë gra dhe burra nuk e gjejnë vetën të përgatitur për treg pune. Natyrisht se ata duan të punojnë por nuk e din se ku dhe çfarë të punojnë. Marrë parasysh faktin se disa gra të reja ose të moshës së mesme, të afta për punë, nuk kanë mbaruar më shumë se shkollim fillor dhe prandaj këto gra nuk ndihen se i përkasin tregut të punës.

Ka shumë profesione që kërkojnë trajnime disamujorshe të cilat do të mund të organizoheshin nga komuna jonë, si, p.sh: kuzhinier/e, rrobaqepës/e, pastrues/e, floktar/e, punëtor/e në fabrika të ndryshme, shitës/e, mekanik, kujdestarë/e për pleq ose për fëmijë etj.

Komuna jonë duhet të bëjë organizime vjetore për të treguar mundësitë e tregut të punës për këtë kategori të të papunëve. Mungesa e informacionit dhe mungesa e aftësisë së qasjes në informacion ka humbur interesimin e shumë punëtorëve potencial të komunës sonë.

Prandaj, bazuar në Ligjin për Barazi Gjinore Ligji Nr. 05/L-020, neni 17, pika 1.8, ku thuhet se punëdhënësi/ja duhet:

“të sigurojë që femrat dhe meshkujt të kenë mundësi të barabarta për të vazhduar shkollimin dhe aftësimin profesional dhe të përcjellin trajnimet të cilat mbahen për të shtuar shkathhtësitë profesionale ose të përgatiten për profesione të tjera”

Ky rekomandim i është dërguar: Zyrës për Barazi Gjinore.

KKBGJ-ja gjatë vitit 2022, ka qen pjesë aktive e katër organizimeve (temave) siç janë:

1. “Fuqizimi i zërave gjithëpërfshirës të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë.”
2. Takim me të gjitha komitete konsultative në komunën e Drenasit dhe më qytetaret.
3. “Kanceri i gjirit dhe parandalimi i tij.” – Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të kancerit të gjirit.
4. “25 Nëntori, Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës në Familje.” dhe “16 Ditët e Aktivizimit.”

